



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:019222

Datë: 09.02.2024

Numri i dokumentit: 05306616

KPPP.nr.104/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Euro - Art” SH.P.K., me numër unik identifikues 810199704 me seli në Ferizaj, Magjistralja Viti-Gërlicë km. 7, kundër debitorit “Nomma Studio” SH.P.K., me numër unik identifikues 811470236 me seli në Prishtinë, rruga “Agim Ramadani” p.n., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson D. R., avokate nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.656/2023 të datës 26.12.2023, të Përmbartuesit Privat Besnik H. Aliu, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datës 09.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Nomma Studio” SH.P.K., i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.656/2023 të datës 26.12.2023, të Përmbartuesit Privat Besnik H. Aliu, me seli në Ferizaj.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.656/2023 i datës 26.12.2023, i Përmbartuesit Privat Besnik H. Aliu, me seli në Ferizaj.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Euro - Art” SH.P.K., ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.656/2023 të datës 26.12.2023, me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës Nr. 029/2022 të datës 26.05.2022 në shumë prej 25,642.52€, nga e cila shumë debitori përmes transferit bankar të datës 30.05.2022 ka paguar shumën prej 15,000.00€, ndërsa ka mbetur borxh kreditorit shumën në vlerë prej 10,642.52€, për të cilën shumë debitori është detyruar t’ia paguaj kreditorit në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të propozimit bashkë me kamatë ligjore prej 8% nga data e kalimit të afatit për pagesë

me datë 03.06.2022 e deri në përmbushjen definitive si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore. Të gjitha këto do të realizohen përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit të hapura në bankat komerciale të Kosovës, nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbartuesi privat do të zbatoj përmbartimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit me shitjen e tyre dhe të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit, përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor me pretendimin se dokumenti në bazë të së cilit është përpiluar propozimi për përmbartim nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, pasi që fatura e bashkangjitur është faturë e falsifikuar nga ana e kreditorit dhe se e njëjta nuk mund të konsiderohet dokument i besueshëm. Ka shtuar se nënshkrimi dhe vula e debitorit janë falsifikuar, për çka ka pohuar se do të iniciojnë procedurë penale. Gjykatës i ka propozuar që të pranoj si të bazuar prapësimin e debitorit dhe të anuloj Urdhrin Përmbartimor P.nr.656/2023 të datës 26.12.2023 si dhe ta obligoj kreditorin që në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguaj 156€.

Kreditori brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara. Tutje ka shtuar se kreditori në mënyrë ë vazhdueshme ka lëshuar fatura për debitorin i cili i ka pranuar me rregull, kjo vërtetohet edhe nga vula dhe nënshkrimi, duke e konsideruar të çuditshëm faktin se si tani konteston faturat të cilat i ka pranuar me rregull. Më tej ka shtuar se fatura në bazë të së cilës është iniciuar procedura përmbartimore është dokument i besueshëm dhe ka të gjitha tiparet e përmbartueshmërisë dhe pjesërisht e ka përmbushur, andaj i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të lë në fuqi urdhrin përmbartimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit në përgjigjen në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkakët si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”* dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret, gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht Nr. 029/2022 të datës 26.05.2022 në shumë të përgjithshme prej 25,642.52€, nga e cila shumë debitori përmes transferit bankar të datës 30.05.2022 ka paguar shumën prej 15,000.00€, ndërsa ka mbetur borxh kreditorit shumën në vlerë prej 10,642.52€, andaj gjykata vlerëson se fatura e lartcekur i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, mbanë nënshkrimin dhe vulën e debitorit si dëshmi e pranimet me rregull nga ana e debitorit.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit lidhur me falsifikimin e nënshkrimit të debitorit dhe pretendimin për inicimin e procedurës penale, mirëpo gjeti se debitori me asnjë provë të vetme nuk arriti të vërtetoj pretendimin e paraqitur në prapësim andaj, Gjykata u lëshua vetëm në vlerësimin e elementeve formale të dokumentit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi, dhe i cili në formën e paraqitur, përmban të gjitha elementet e dokumentit të besueshëm të përcaktuara me nenin 29 par. 3 të LPP-së, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbartimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.104/24, datë 09.02.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.